



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

AWR

ABBRUCH

GMBH

www.awr-abbruch.de

SI TË SHTYHEN
KOSOVA DHE SERBIA
DREJT NORMALIZIMIT?

FAQE 3



Shefja e diplomacisë e Bashkimit Evropian paralajmëroi shqyrtimin e mjeteve alternative

ndaj dialogut në mënyrë që Kosova dhe Serbia të bëjnë hapa drejt normalizimit të raporteve.

Po si e shohin njohës në Prishtinë dhe në Evropë rrugën përpara?

MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT: DREJTËSIA DO TË TRIUMFOJË, AKTGJYKIMI PËRFUNDIMTAR DO TA VËRTETOJË PAFAJËSINË

F.6



“JEMI NË SIKLET”: PASOJAT PËR BIZNESET E KOSOVËS PAS VENDOSJES SË TARIFËS NGA SHBA-ja

F.3



MARCO RUBIO: DUAM QË NATO-ja TË JETË MË E FORTË

F.2

KRIMINELËT E LUFTËS DUHET TË GJENDEN DHE TA VUAJNË DËNIMIN E MERITUAR

F.5

RIVARROSEN MBETJET MORTORE TË DHJETË VIKTIMAVE TË LUFTËS, KOSOVA I PËRCJELL ME NDERIME

F.5

EKONOMI



ATK-ja SHËNON RITJE TË TË HYRAVE PËR PERIUdhËN JANAR - MARS

F.8

QEVERIA THOTË SE PO SHOYRTON TARIFËN NDAJ IMPORTEVE NGA SHBA-ja

F.8

SPORT



MINISTRI ÇEKU DHE KOK-u KËRKOJNË SQARIM NGA UEFA PËR HEQJEN E FLAMURIT TË KOSOVËS NË BEOGRAD

F.6

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Marco Rubio: Duam që NATO-ja të jetë më e fortë

BRUKSEL, 4 PRILL - Ndryshe nga shqetësimet për tërheqje të mundshme të ShBA-së nga NATO, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, u shpreh se ShBA-ja i mbetet besnik NATO-s. Fillimi i takimit dyditor të ministrave të Jashtëm të NATO-s u la në hije nga tarifat e importit të vendosura nga Uashingtoni për mallrat edhe nga Evropa të mërkurën. Ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Xavier Bettel, foli për një “moment të së vërtetës” që do të tregonte, nëse ShBA do të donte ende të kishte të bënte me Evropën. Në këtë kontekst edhe ministrja e Jashtme gjermane në detyrë, Annalena Baerbock (Të Gjellrit), e bëri të qartë rëndësinë e sigurisë ekonomike për aftësinë mbrojtëse. Siguria ekonomike është “pjesë e sigurisë sonë të përgjithshme”, theksoi ajo në Bruksel. Në muajt e fundit Trumpi kishte vënë vazhdimisht në pikëpyetje

klauzolën e mbrojtjes reciproke të NATO-s dhe kërkonte që partnerët e NATO-s t'i rrisnin buxhetet e tyre të mbrojtjes në pesë për qind të PBB-së së tyre përkatëse. Deklaratat nga Uashingtoni nxitën frikën në mesin e diplomatëve të NATO-s në Bruksel se ShBA-ja mund të tërhiqet të paktën pjesërisht nga NATO. Sipas sekretarit të Shtetit, Marco Rubio, ShBA-ja është e përkushtuar ndaj NATO-s. Kjo nuk ka ndryshuar, tha Rubio në Bruksel, para takimit dyditor me krerët e departamenteve nga 32 vendet anëtare që filloi të enjten. Presidenti amerikan Donald Trump e ka bërë të qartë se ai mbështet NATO-n. “Ne do të mbetemi në NATO”, tha Rubio në Bruksel të enjten. Sipas Rubios, Shtetet e Bashkuara janë edhe “më aktive se kurrë” në NATO. “Histeria dhe ekzagjerimi që keni parë në mediet ndërkombëtare dhe në disa medie amerikane për këtë çështje janë të pajustificuara.

Por ne duam që NATO të jetë më e fortë”, tha ai. Në të njëjtën kohë, ai theksoi se NATO-ja duhet t'i forcojë aftësitë e saj për t'u përgatitur për kërcënimet ekzistuese. Për këtë qëllim, ai konsideron të përshtatshme shpenzime të mbrojtjes në pesë për qind të prodhimit të brendshëm bruto. Rubio pranoi se ShBA-ja nuk e ka arritur ende këtë objektiv. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë është “që partnerët tanë (...) të kenë më shumë aftësi”. “Ne duam që NATO të jetë më e fortë. Ne duam që NATO të jetë më efikase. Dhe e vetmja mënyrë që NATO të jetë më e fortë dhe më efektive është që partnerët tanë (...) të kenë më shumë aftësi”, tha Rubio. Rubio tha se e kupton se, pas dekadash të ndërtimit të sistemeve gjithëpërfshirëse të sigurimeve shoqërore, mund të jetë jopopullore të devijosh prej tyre dhe të investosh më shumë në sigurinë kombëtare. Por ngjarjet e viteve të fundit, duke



përfshirë luftën aktuale në zemër të Evropës, janë një kujtesë se një fuqi e fortë mbetet e nevojshme si pengesë. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka hedhur poshtë frikën për një tërheqje të shpejtë të trupave amerikane nga Evropa. Nuk ka plane për këtë, tha ai në Bruksel. Ai vazhdon ta konsiderojë ShBA-në partnere të besueshme. Tema të tjera në takimin dyditor

në Bruksel lidhen me situatën në Ukrainë dhe negociatat për armëpushimin që Uashingtoni po zhvillon aktualisht me Moskën dhe Kiyvin. Përveç anëtarëve të NATO-s, në takim morën pjesë edhe shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, ministri i Jashtëm ukrainas Andriy Sybiha dhe përfaqësues të Japonisë, Koresë së Jugut, Australisë dhe Zelandës së Re.

Studentët protestues serbë, me biçikleta drejt Strasburgut

NOVI SAD, 4 PRILL - Me brohoritje dhe lot në sy dhjetëra studentë nga Novi Sadi kanë nisur udhëtimin dyjavor me biçikleta drejt Strasburgut, ku duan ta tërheqin vëmendjen e BE-së për luftën e tyre kundër korrupsionit në Serbi. Serbia prej javësh është përfshirë nga një valë protestash në mbarë vendin kundër korrupsionit në nivelet e larta të institucioneve. Vala e protestës mori shkas nga rrëzimi i çatisë së betonit në stacionin e trenit në Novi Sad nëntorin e kaluar (2024), ku si pasojë humbën jetën 16 veta. Indinjata publike për tragjedinë në Novi Sad ka të bëjë me

përgjegjësinë për këtë fatkeqësi që bie ndaj figurave drejtuese, që nuk ndërmarrin sa duhet kundër korrupsionit dhe që nuk janë kujdesur për mbikëqyrjen e duhur të projekteve të ndërtimit. Studentët janë angazhuar masivisht me përkushtim në protesta duke gjetur vazhdimisht forma paqësore, por intensive proteste për të sensibilizuar mbi problemet. Turi me biçikleta drejt Strasburgut synon sensibilizimin e BE-së për problemet e Serbisë, raporton dw/afp. Me helmata në kokë dhe xhaketa fluoreshente si dhe të mbështjellë me flamurin e Serbisë, rreth 80 studentë nisen pedalimin nga



kompleksi i Universitetit të Novi Sadit deri në destinacionin 1.800 km larg në Perëndim. Gjatë udhëtimit studentët do të kalojnë nëpër disa metropole të BE-së, Budapest, Bratislavë, Vjenë, Muni, ku ata krahas Evropës duan ta sensibilizojnë edhe diasporën serbe në këto

vende. Nga banorët e Novi Sadit studentët u përçollën me brohoritje me fjalët “pumpaj”, “pumpaj”, një nga sloganet e protestës (pompoje). Serbia është një vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe Brukseli i ka kërkuar të ndërmarrë masa për promovimin e lirisë së medias, luftën kundër korrupsionit dhe reformimin e sistemit elektoral, por një pjesë e protestuesve mendojnë se Evropa nuk mban qëndrim si duhet dhe është shumë e butë kundrejt qeverisë në Beograd. Studentët dhe qytetarët

protestues kanë zhvilluar tur me këmbë edhe brenda vendit duke ecur prej ditësh në mes të marsit në drejtim të kryeqytetit të Serbisë. Dhjetëra protesta e incidente kanë ndodhur vetëm gjatë javës. Presidenti Aleksandër Vuçiq dhe pushteti i tij deri më tani nuk janë dorëzuar. Ai thotë se protestave u ka ardhur fundi, ndërsa studentët thonë se vendosin ata dhe jo presidenti. Protestat çuan deri te dorëheqja e kryeministrit Millosh Vukçević. Studentët thonë se protestat nuk do të ndalen dhe se fundi i tyre nuk do të vijë kur ta thotë presidenti, por kur të thonë ata se janë plotësuar kushtet.

Britania dhe Franca e akuzojnë Putinin për pengim të armëpushimit

LONDËR, 4 PRILL - Britania dhe Franca e kanë akuzuar presidentin rus Vladimir Putin se po i zvarrit bisedimet për një armëpushim, që synojnë ndaljen e pushtimit të Ukrainës nga Rusia, dhe kanë kërkuar përgjigje të shpejtë nga Moska pas përpjekjeve të Shteteve të Bashkuara për të siguruar armëpushim. Rusia në mënyrë efektive ka refuzuar një propozim amerikan për një ndalje të plotë të luftimeve për 30 ditë, teksa Ukraina e ka pranuar planin e Uashingtonit. “Sipas mendimit tonë, Putini po vazhdon ta mjugullojë situatën, po vazhdon ta zvarrisë procesin”, tha sekretari i Jashtëm britanik,

David Lammy, për gazetarët në selinë e NATO-s, duke qëndruar përkrah homologut të tij francez Jean-Noel Barrot. I dërguari i Kremlinit, që ka vizituar Uashingtonin gjatë kësaj jave për të zhvilluar bisedime me zyrtarët e administratës së presidentit amerikan Donald Trump, tha se duhen edhe takime të tjera për t'i zgjidhur çështjet e hapura. Kirill Dmitriev tha për gazetarët rusë “se për dialogun duhet kohë, por është duke shkuar në mënyrë pozitive dhe konstruktive”. Ai kritikoi atë që e quajti “fushatë të koordinuar mediale dhe përpjekje nga disa politikanë për t'i prishur raportet Rusi-ShBA, për të



shtrembëruar atë që e thotë Rusia dhe për ta paraqitur Rusinë dhe udhëheqësit e saj në një mënyrë negative”. Britania dhe Franca po udhëheqin përpjekjen shumëkombëshe të njohur si “koalicioni i vullnetit”, duke synuar krijimin e një force të sigurisë e cila do të dislokohej në Ukrainë në rast se në të

ardhmen arrihet një marrëveshje armëpushimi. Një zyrtar i lartë ukrainas tha më herët gjatë javës se midis dhjetë deri në 12 vende deri më tani kanë thënë se do t'i bashkohen këtij koalicioni. Lammy tha se përderisa Putini duhet të pranojë një marrëveshje armëpushimi, “ai po vazhdon ta bombardojë Ukrainën. Po bombardon popullatën e saj civile, furnizimet e energjisë. Ne po e shohim se si po vepron Putini, e dimë se çfarë po bën”. Barrot tha se Ukraina para tre javësh ka pranuar kushtet për armëpushim dhe tani Rusia “tani ia ka borxh ShBA-së një përgjigje”. “Rusia po e zvarrit

procesin, po vazhdon sulmet ndaj infrastrukturës së energjisë, po vazhdon krimet e luftës”, tha Barrot. “Duhet të thotë ‘po’ dhe duhet të japë një përgjigje shpejt”. Sipas ministrit francez, Rusia nuk ka shfaqur asnjë sinjal se dëshiron ta ndalë fushatën ushtarake, duke kujtuar se të hënën Putini urdhëroi rekrutimin e 160 000 ushtarëve të rinj për shërbim të detyrueshëm ushtarak për një vit. Dy ministrat u zotuan se do të vazhdojnë ta ndihmojnë Ukrainën që ta forcojë ushtrinë e saj, teksa Kievi që nga viti 2022 është duke u përballur me pushtimin e nisur nga Moska.

SI TË SHTYHEN KOSOVA DHE SERBIA DREJT NORMALIZIMIT?

Shefja e diplomacisë e Bashkimit Evropian paralajmëroi shqyrtimin e mjeteve alternative ndaj dialogut në mënyrë që Kosova dhe Serbia të bëjnë hapa drejt normalizimit të raporteve. Si e shohin njohës në Prishtinë dhe në Evropë rrugën përpara?

PRISHTINË, 4 PRILL - “Ndoshta është dialogu, ndoshta është një tjetër mjet. Jam e gatshme ta shqyrtoj këtë çështje, dhe do ta bëj këtë së bashku me përfaqësuesin e Posaçëm [për dialogun, Peter Sorensen] në ditët në vijim”. Kështu deklaroi për Radion Evropa e Lirë (REL) përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, teksa tha se BE-ja është e interesuar të shohë përparim drejt normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë.

Por për Donika Eminin, nga Grupi Këshillëdhënës në Evropë për Politika të Ballkanit (BIEPAG), ndonëse kjo deklaratë, siç shprehet ajo, mund të duket si “diçka pompoze e inovative, fatkeqësisht nuk është”. Ajo thotë për REL-in se, nga vizita në Prishtinë e emisarit të BE-së për dialogun, dhe nga bisedat që ka zhvilluar në Bruksel, ka fituar përshtypjen se në bllokun evropian “tendencat janë që dialogu të kthehet sërish në nivel teknik, sepse BE-ja ende e konsideron dialogun teknik 2011-2013 si pjesën më të rëndësishme dhe më të suksesshme” të procesit.

Objektivi i dialogut

Megjithatë, sipas Eminin, nuk mund të jetë objektiv i

ndërmjetësimit të BE-së normalizimi i raporteve mes dy vendeve, pa pasur qartësi se çfarë realisht nënkupton ai, sa do të zgjasë procesi dhe si do të përfundojë.

Emini vlerëson se BE-ja duhet ta përmbyllë procesin e dialogut me një marrëveshje që ka përmbajtje të qartë, e jo ta quajë veten vetëm lehtësuese të procesit dhe të thotë se sheh edhe instrumente të tjera përveç dialogut, për të arritur normalizimin. “Përndryshe, vazhdojmë kështu në mënyrë teknike, njerëzit në BE paguhen të punojnë me ne, ndërsa ne e luajmë derën në rajon dhe i shtyjmë edhe pesë apo dhjetë vjet kështu, derisa të bëhet diçka më e madhe ose të ketë ndërhyrje nga aktorë jashtë BE-së”.

Toby Vogel, nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Berlin, pohon se qëllimi përfundimtar, që, sipas tij, është një marrëveshje ligjërish e obligueshme për një normalizim gjithëpërfshirës, “është harruar” përgjatë procesit, i cili ka nisur më 2011 - fillimisht në nivel teknik, e më pas në atë politik.

Ai thotë për REL-in se nga deklarata e Kallasit kuptoi se në BE janë drejt përfundimit të rivlerësimit të politikës sa i përket procesit negociues të



lehtësuar nga blloku, për të kuptuar se “çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo në dialog deri më tani”.

Një qasje e re ndaj procesit

Vogel vlerëson se dialogu Kosovë-Serbi duhet të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë të BE-së. Ai konsideron se, fillimisht, duhet të shihet ajo që ka ndodhur në dialog, si dhe qasja që BE-ja ka pasur, e cila, sipas tij, ka qenë “e anuar në favor të Serbisë”.

Ndonëse procesi ka prodhuar dy marrëveshje të mëdha - atë të Brukselit më 2013, dhe atë të Ohrit më 2023 - Vogel thotë se Kosova nuk e ka zbatuar marrëveshjen për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, por edhe Serbia, “me tolerimin” e BE-së, nuk ka zbatuar asnjë zotim

dhe ka zhvilluar fushatë kundër njohjeve të reja dhe kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Sipas Vogelit, shefja e re e diplomacisë e BE-së nuk duhet ta lërë “të pandëshkuar” Serbinë për shkak të mospërshtatjes së politikës së jashtme me atë të bllokut. Ai konsideron se ngecja në dialog ka ndodhur pasi BE-ja e ka trajtuar procesin si të ndarë nga politika e tij e jashtme.

Edhe Emini mendon se Brukseli duhet ta ndryshojë qasjen në dialog. Sipas saj, vetëm “presioni ndaj Kosovës” - e cila është nën masa ndëshkuese nga BE-ja - nuk mjafton që dialogu të ketë sukses, pasi problemi, për të, qëndron te presidenti Aleksandar Vuçiq në Serbi. Zyrtarët në Kosovë shpesh janë ankuar për një qasje të

pabalancuar në dialog, kur lehtësues të tij ishin Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak - figura nga dy shtete brenda bllokut që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Për Vogel, nuk ka kuptim që dialogu të rinisë me qasje të njëjtë gjatë mandatit të Kallasit, dhe as nëse Serbia vazhdon të thotë se kurrë nuk do ta njohë Kosovën.

Ai vlerëson se procesi duhet të riformatohet dhe t'i kthehet objektivit origjinal: të jetë i përqendruar plotësisht në arritjen e një marrëveshjeje finale, e jo të përdoret për menaxhim të krizave.

Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që rriten tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë rund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve.

MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT: DREJTËSIA DO TË TRIUMFOJË, AKTGJYKIMI PËRFUNDIMTAR DO TA VËRTETOJË PAFAJËSINË



PRISHTINË, 4 PRILL - Avokatja e Jakup Krasniqit në Hagë, Venkateswari Alagendra, ka dhënë përgjigje për “Klan Kosova” rreth procesit gjyqësor të klientit të saj. Ajo thotë se për Krasniqin rruga e tij drejt drejtësisë ka qenë e gjatë dhe e mbushur me plot sfida, derisa shton se për mbi katër vjet mbrojtja ka qenë e palëkundur në përkushtimin e saj për të vërtetën dhe drejtësinë. “Për z. Jakup Krasniqi, rruga drejt drejtësisë ka qenë e gjatë dhe e mbushur me plot sfida. Duhet të theksohet se kanë kaluar gati katër vjet e gjysmë që kur klienti im është arrestuar, përfshirë fazën e procedurës

paraprake të gjyqimit dhe dy vjet të plota që kur ka nisur gjykimi. Përgjatë kësaj periudhe, mbrojtja ka qenë e palëkundur në përkushtimin e saj për të vërtetën dhe drejtësinë. Që nga fillimi i gjyqimit, strategjia jonë ligjore ka qenë e bazuar në fakte, ligj dhe integritet. Gjatë paraqitjes së rastit të Prokurorisë, ne vazhdimisht kemi mbajtur dhe vërtetuar qëndrimet që kemi prezantuar në fjalën hyrëse. Ato qëndrime mbesin të palëkundura”, ka deklaruar ajo. Ndër të tjera, për “Klanin”, Alagendra tha se mbrojtja mbetet e palëkundur në bindjen se drejtësia do të

triumfojë dhe aktgjykimi përfundimtar do ta vërtetojë pafajësinë e Krasniqit. “Duke iu afruar përmbjlljes formale të rastit të Prokurorisë gjatë ditëve të ardhshme, edhe ne do të vazhdojmë me hapat tjerë procedural siç parashihet me Rregulloren. Ne jemi të përkushtuar për t’u siguruar që këta hapa të përmbushen pa vonesë ashtu që verdikti përfundimtar të merret sa më parë që është e mundur. Ne mbesim të palëkundur në bindjen tonë se drejtësia do të triumfojë dhe aktgjykimi përfundimtar do ta vërtetojë pafajësinë e z. Krasniqi”, ka theksuar Alagendra.



MAQEDONCI: FAKTI QË GRUPI I RADOJICIQIT QË KREU SULMIN NË BANJSKË ËSHTË I LIRË NË SERBI, RREZIKU PËR DESTABILIZIM EKZISTON

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri i Mbrojtjes në detyrë, Ejup Maqedonci, ka thënë se me vetë faktin që grupi terrorist i cili kreu sulmin në Banjskë në shtatorin e vitit 2023, dhe që synonte aneksimin e një pjese të Kosovës, vazhdon të jetë i lirë, i mbështetur e i mbrojtur nga Serbia, ekziston rreziku që ta provojë destabilizimin e Kosovës.

Maqedonci në një intervistë për RTK-në tha se institucionet e Republikës janë aq të përgatitura saqë të mposhtin çdo rrezik që vjen për vendin. “Është theksuar nga të gjitha dikasteret tona qeveritare, është theksuar nga kryeministri

shumë herë, edhe nga ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Policisë, edhe nga unë, fakti se grupi po vazhdon të mbetet i lirë. Ai grup që ka kryer akt terrorist, që ka qenë një grup i organizuar, i armatosur, i uniformuar, që ka synuar aneksimin e një pjese të territorit tonë, përveç që po mbetet i lirë në Serbi, po vazhdon të jetë i mbështetur e i mbrojtur pikërisht nga strukturat e sigurisë së Serbisë brenda saj dhe shpesh jo larg kufirit me Kosovën. Dhe normalisht që ky grup vazhdon të ketë kontakte edhe me elementë, individë në veri të vendit tonë. E normalisht që ky

grup vazhdon t’i ketë ato synime që ka pasur për destabilizimin e pjesës veriore”, tha Maqedonci.

Sipas tij, duke vazhduar Serbia të qëndrojë në politikën hegjemoniste në raport me fqinjët e saj, duke vazhduar ta mohojë ekzistencën e Republikës së Kosovës shtet i pavarur, duke vazhduar përmes luftës hibride të kontribuojë në destabilizimin e vendit tonë, por edhe të vendeve të tjera fqinje, “i gjithë ky është indikacion që rreziku ekziston”. “Por ekziston edhe mundësia e madhe e institucioneve tona që ta mposhtin çdo rrezik për vendin tonë, për faktin që tani

nuk është viti 2020. Në veri kemi strukturat tona shtetërore, kemi administratën shtetërore, kemi Policinë e Kosovës, nuk është situata e para disa vitesh kur ka pasur mundësi të destabilizohet nga grupe të caktuara, dhe nuk është situata si e para disa viteve”, tha ai.

Maqedonci tha se Serbia e ka obligim ndërkombëtar t’i dorëzojë terroristët në vendin ku e kanë kryer krimin, në Kosovë. Ai, po ashtu, tha se Serbia në vazhdimësi e ka ndërlidhur veprimtarinë e saj në mbështetje të këtyre grupeve terroriste në të kaluarën, por edhe të aktivitetëve të tjera në

kontekstin gjeostrategjik, por edhe me kontekstin ndërkombëtar. “Normalisht që Serbia për një kohë është duke vazhduar ta monitorojë për së afërmi përfundimin e luftës në Ukrainë duke shpresuar në fuqizimin e Rusisë si një aleat i saj historik, shekullor dhe si një aleat që e ka mbështetur në të gjitha proceset kundër Kosovës... Besoj se Serbia ka pritur dhe vazhdon të presë një momentum, mirëpo në anën tjetër ne jemi duke u fuqizuar mjaftueshëm në të gjitha kapacitetet jo për të sulmuar dikë, por për ta mbrojtur veten pavarësisht fuqisë së kundërshtarit”, tha Maqedonci.

Hoti: Është jetike për Kosovën të kemi një qeveri proamerikane dhe proevropiane

PRISHTINË, 4 PRILL - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar se Kosovës i është bërë dëm i madh me moszbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit të cilën e kishte nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në vitin 2020. “Dëm i madh për Kosovën që nuk u zbatuan marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2020, në qeverinë e udhëhequr nga LDK-ja dhe partnerët e saj: 1.

Marrëveshja e Uashingtonit e 4 shtatorit 2020, e cila përfshinte projekte të mëdha infrastrukturore, projektin e gazit në veçanti, e cila do të kishte krijuar pavarësi energjetike e nuk do të përballeshim sot me rritje të çmimit të energjisë për herë të tretë në dy vitet e fundit, si dhe do të kishim siguri të furnizimit. 2. Marrëveshja për Insentivat në Investime ShBA-



Kosovë, e datës 31 dhjetor 2020, e cila përfshinte mundësinë që DFC të mbështeste bizneset përmes

huadhënies dhe investimeve në ekuitet, garancive investive, sigurimit të investimeve, projekte të fizibilitetit etj. 3. Memorandumi i Mirëkuptimit ShBA-Kosovë, i datës 23 tetor 2020, për bashkëpunimin mes dy vendeve sa i përket sigurisë së teknologjisë 5G”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Ai ka thënë se sikurse këto marrëveshje të zbatoheshin, sot partneriteti strategjik i

Kosovës me ShBA-në do të ishte në nivele shumë të larta. “Është jetike për Kosovën të kemi një qeveri proamerikane dhe proevropiane, e cila e kthen miqësinë e ngushtë të Kosovës me ShBA-në, që iu kthehet zbatimit të këtyre marrëveshjeve, që mund të udhëtojnë kurdo që është e nevojshme në Uashington për konsulta dhe për mbështetje”, ka shkruar Hoti.

KRIMINELËT E LUFTËS DUHET TË GJENDEN DHE TA VUAJNË DËNIMIN E MERITUAR

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 PRILL - Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, së bashku me këshilltaren për Sigurinë e Njeriut nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, Sarah Jaquiere, kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani-Rama, prokurorin special në Prokurorinë Speciale të Kosovës, Ilir Morina, morën pjesë në tryezën e diskutimit mbi lansimin e Raportit për Monitorim të Gjykimeve për Krimet e Luftës në Kosovë, me titull: “Thyerja e heshtjes: drejtësia për viktimat e luftës?”, organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK).

Gjatë fjalës së tij hyrëse, zëvendësministri Qorrolli theksoi rëndësinë e angazhimit të institucioneve të Kosovës për sigurimin e drejtësisë dhe barazisë për viktimat e krimeve të luftës. Ai foli edhe për përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë së Kosovës për të garantuar procese gjyqësore të drejta dhe ofrim të mbështetjes së duhur për viktimat.

Raporti i FDHK-së shpalos rekomandime kyçe, duke përfshirë mundësimin e gjykimeve në mungesë si një hap të rëndësishëm për vënien e drejtësisë. Nga 35 raste të monitoruara, 15 janë zhvilluar në mungesë të të pandehurve. “Kriminelët e luftës duhet të gjenden dhe ta vuajnë dënimin e merituar, por gjykimi në mungesë është një mekanizëm jetik për drejtësinë”, theksoi



Qorrolli. Më tutje, zëvendësministri Qorrolli rikujtoi se krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga shteti i Serbisë gjatë luftës në Kosovë kanë lënë pasojë të thella jo vetëm për viktimat e drejtpërdrejta, por edhe për tërë shoqërinë.

Në këtë drejtim, sipas Qorrollit, Qeveria e Kosovës ka prioritetizuar krijimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale, e cila trajton shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës, bazuar në parime të qarta si: qasja e përqendruar te viktimat, ndjeshmëria gjinore, pajtueshmëria me standardet ndërkombëtare dhe barazia.

Përveç qasjes në drejtësi, zëvendësministri Qorrolli tha se Strategjia thekson nevojën për

forcimin e sistemit të drejtësisë dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale, si dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Për t'i përforcuar kapacitetet e institucioneve të drejtësisë, Ministria e Drejtësisë ka ndarë buxhet për shtimin e tre prokurorëve, pesë bashkëpunëtorëve profesionalë dhe dy përkthyesve që do të fokusohen ekskluzivisht në krimet e luftës. “Drejtësia nuk është vetëm ndëshkim i kriminelëve, por një mundësi për pajtim dhe ndërtim të një të ardhmeje të drejtë dhe të barabartë për brezat që vijnë”, deklaroi zëvendësministri Qorrolli.

Në këtë drejtim, sipas Qorrollit, Qeveria e Kosovës ka prioritetizuar krijimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale, e cila

trajton shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës, bazuar në parime të qarta si: qasja e përqendruar te viktimat, ndjeshmëria gjinore, pajtueshmëria me standardet ndërkombëtare dhe barazia.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani-Rama, tha se Departamenti Special ka shënuar përparim në trajtimin e lëndëve të krimeve të luftës. Sipas saj, gjyqtarët e Themelores janë të përgatitur profesionalisht për trajtimin e këtyre rasteve. Por, Shabani-Rama theksoi se aspekti i përkthyesve dhe sidomos mungesa e bashkëpunimit juridik me Serbinë janë sfidat kryesore në trajtimin e këtyre rasteve.

Udhëheqësi i Departamentit për Krime Luftë pranë Prokurorisë Speciale, Ilir

Morina, tha se nga viti 2023 kanë bërë punë të konsiderueshme në adresimin e krimeve të luftës. Sipas tij, janë ngritur 14 aktakuza në mungesë nga Prokuroria Speciale, derisa si sfidë edhe prokurori speciale, Morina, identifikoi mungesën e përkthyesve.

Amer Alija nga Fondi për të Drejtën Humanitare ka theksuar se që nga përfundimi i luftës institucionet gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare kanë dënuar rreth 74 persona për krimet e luftës në Kosovë.

Me qëllim të tejkalimit të sfidave nga FDHK-ja, kanë rekomanduar krijimin e një bashkëpunimi me gjyqësor rajonal dhe ndërkombëtar, në veçanti me shtetin serb dhe përkthimin e shkresave të luftës në gjuhën serbe, kur palët e përfshira janë nga ky komunitet.

RIVARROSEN MBETJET MORTORE TË DHJETË VIKTIMAVE TË LUFTËS, KOSOVA I PËRCJELL ME NDERIME

PRISHTINË, 4 PRILL - Me nderime shtetërore janë rivarrosur mbetjet mortore të dhjetë viktimave të luftës që ishin në listën e personave të zhdukur, të identifikuar së fundmi nga mbetjet mortore të zhvarrosura nga varreza masive në Bishtazhin të Gjakovës.

Ceremonia e rivarrimit të martirëve Adem (Hazar) Gashi, Sahit (Ahmet) Gashi, Bekim (Hashim) Hasani, Sheremet (Brahim) Ismajl, Osman (Kadri) Fejza, Shkelzen (Rifat) Hajdaraj dhe Bekim (Muharrem) Gashi u mbajt në Kompleksin Memorial “Kodra e Kuqe” në Grabanicë të Klinës.

Ndërkohë, në një akademi përkujtimore në Klinë, me dhimbjen e familjeve për të pagjeturit edhe pas më shumë se dy dekadash pas luftës së fundit në Kosovë, u kujtua sakrifica e martirëve.

Në emër të Kuvendit të Kosovës, nënkryetarja në detyrë, Saranda Bogujevci, shprehu ngushëllimet dhe nderimet më



të larta për sakrificën e të rënëve të kombit, raporton “KosovaPress”. Ajo tha se dëshmorët dhe martirët janë amaneti më i çmuar i vendit

tonë. Përfaqësuesi i presidencës, Ismet Krasniqi, tha se ky nuk është vetëm një akt rivarrimi, por një çast reflektimi për

dhimbjen dhe padrejtësinë që pësuan familjet dhe gjithë kombi ynë. Krasniqi tha se përulemi me respekt të thellë para sakrificës

së martirëve të rënë për lirinë e Kosovës. Ai potencoi se kërkimi për drejtësi nuk do të ndalet derisa të zbardhet fati i të gjithë të pagjeturve.

Andin Hoti nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur tha se 4 prilli në Klinë nuk është thjesht një datë kalendarike, por është një plagë që nuk është shëruar asnjëherë.

Kryetari i Shoqatës për të Pagjeturit në Klinë, Zeqir Morina, u shpreh se rivarrimi i eshtrave të martirëve të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë “është një moment që na bënë të kuptojmë se liria nuk është diçka që mund të dhurohet, por është një e drejtë që është arritur pas shumë sakrificave”.

Ndërkaq në Jashanicë të Klinës është bërë rivarrimi i viktimës së luftës Mentor (Xhemajl) Myrtaj, në Malishevë është bërë rivarrimi i Vehbi (Pajazit) Halilajt, ndërsa në varrezat e fshatit Bubavec është bërë rivarrimi i Mentor (Maliq) Kryeziut.

A DO TË MBETET PAT APO DO TË BËHET MAT?!



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

50 për qind me 50 për qind: Pas zgjedhjeve të fundit kemi një situatë ku votat shqiptare thuaja janë 50 për qind me 50 për qind. LV-ja ka 48 deputetë kurse PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-Nisma i kanë 52 deputetë që nënkupton se asnjëri komunitet politik nuk e formon qeverinë pa pakicat që i kanë të garantuar 20 deputetë. LV-ja është sjell me opozitën shqiptare me shpërfillje aq të paskrupullt që mund të cilësohet edhe si sadizëm. Pas zgjedhjeve Albin Kurti e quajti opozitën, bashkë me familjarë, hajvanat që është fyerje e rëndë. Reagimi i opozitës ishte i qullët, anemik, në shpërputhje të madhe me fyerjet që iu bënë. Albin Kurthi ishte i dekurajuar me rezultatin prandaj doli nga kuadrati i një sjelljeje normale dhe të përgjegjshme. Për sjellje përbashkuese as që bëhej fjalë. Boritë e luftës kundër opozitës, LV-ja i kishte aktive gjatë tërë mandatit duke i shndërruar në vuvuzela shurdhuese para, gjatë dhe pas përfundimit të zgjedhjeve. Pozita deklaroi publikisht se nuk do të bëjë koalicion me hajvanët opozitarë kurse opozita ravijëzoi vija të kuqe ndaj LV-së. Po të kishte gatishmëri opozita të bashkohet në një qeverisje të pakushtëzuar, Albin Baba Kurthi dhe LV-ja 100 për qind do të mbetej në opozitë. Realisht, PDK-ja dhe AAK-ja ishin deklaruar për një qeveri të opozitës ku PDK-ja do ta kishte KM, kurse LDK-ja as gjatë fushatës, as gjatë votimit e as pas certifikimit të rezultateve nuk ishte deklaruar se e duan një qeveri të opozitës. Kjo është e vërteta, ma dëshmoni të

kundërtën! LDK-ja e kërkonte postin e KM pa treguar se me cilin koalicion do të bashkohej. Ndonëse verbalisht të gjitha partitë opozitare e kishin si emërues të përbashkët kundërshtimin ndaj Kurthit, nuk pranuan të bëhen bashkë për materializimin e këtij kundërshtimi duke i lënë hapësirë Kurthit dhe pakicave ta bëjnë qeverinë. LV-ja i ka 48 deputetë, 20 deputetë të pakicave joserbe dhe serbe i bënë 68 deputetë mjaftueshëm edhe për një mandat 4-vjeçar. Realisht, me këtë qeveri të pakicave Albin Kurthi Baba nuk mund ta bëjë asnjë punë të hajrit për Kosovën por mund të bëjë shumë punë të mira dhe të ndyra për Serbinë. Opozita, po ta kishte përnjëmend nuk do të priste se a do e bëjë Kurthi qeverinë a jo që pas kësaj të nisin bisedimet për një koalicion të mundshëm. **Si të dilet nga pozicioni pat:** Po përmenden zgjedhjet e jashtëzakonshme si një shteg dalje. Sipas meje është fort e papërgjegjshme dhe e pamoralshme nga të gjithë akterët nëse e kanë një skenarë të tillë në projektet e tyre politike. Do të ishte keqpërdorim i buxhetit të Kosovës sepse pa asnjë nevojë do të bëheshin rrush dhe kumbulla dhjetëra milionë euro për zgjedhje, fushatë sikur që do të mbesim mbrapa shumë proceseve për një rezultat që nuk do të dallonte shumë nga statusquo aktuale. Nuk ia vlen të mendohet për këtë pa -mundësi. Çka duhet atëherë të bëhet? Pasi Kosovën e presin procese të rënda ku nuk do të

festohet fitorja por do të menaxhohet dëmi dhe dhimbja, do të ishte i nevojshëm një koalicion ku do të përfshiheshin të gjitha partitë politike shqiptare sikur edhe ato të pakicave që do të pranonin të bëhen pjesë konstruktive e këtij procesi. Ne mund dhe duhet të deklarohejmë për kërkesa maksimale mirëpo ndërkombëtarët, evropianë dhe amerikanë që i kemi pranuar si ndërmjetësues haptazi na thonë se duhet të marrim vendime të vështira dhe të dhimbshme. Jemi vonuar shumë dhe çdo ofertë e radhës do të jetë më e keqe sikur që hapësira për refuzim do të pamundësohet. Jemi të izoluar dhe nën sanksione, jemi në pozitën kur vetëm kërkojmë thuaja lëmoshë nga ata që po thonë se duhet të marrim vendime të rënda dhe të dhimbshme. Ka të marrë në qeveri që thonë se nuk duhet ta pranojmë asnjë kushtëzim, me bythë në karriget që ia përshtatin përmasave anatomike. Mendoj se duhet një konsensus kombëtar dhe politik deri të kalohen këto procese e pastaj të mbahen zgjedhjet. Për situatën e sotme të gjithë kanë përgjegjësi kush më shumë e kush më pak, pozitë dhe opozitë. Demahmetizimi folklorik i politikës i mbetjeve patriotike sikur edhe hejsslovenizimi i këshilltarëve kryesorë të Kurthit nuk janë oferta apo rrugë që na nxjerrin nga rruga njëkahore drejt theqafjes që na kanë futë sovranistët e shpifur. Për këtë jemi ku jemi dhe nuk dihet ku do të përfundojmë. Çdo zgjidhje që e përjashton apo pamundëson konsensusin kombëtar dhe

politik i jep fund projektit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Do të shndërrohem në tokë të askujt dhe në plaçkë të çdokujt! Përgjegjësinë kryesore për ndërtimin dhe jetësimin e këtij konsensusi e ka Albin Kurti, si fitues i zgjedhjeve dhe kryetar i partisë më të madhe në Kosovë. **Si po vepron Kurti:** Po e bënë të kundërtën e asaj që duhet dhe e ka detyrim njerëzor, kombëtar, politik, moral dhe kushtetues. Në vend se që ftesat e para për konsultim për formim të qeverisë t'ua dërgojë PDK-së, LDK-së dhe AAK-Nisma e pastaj partive të pakicave, e bëri të kundërtën duke bërë takime me përfaqësues të pakicave që mund ta shpëtojnë me formimin e qeverisë por jo në zgjidhjen e problemeve përcaktuese për Kosovën dhe qytetarët e saj. Kjo mundësi është në dorën e Kurtit e jo të opozitës. Opozita duhet të heqë vijat e kuqe dhe të vetofrohet, pa asnjë kushtëzim për tejkalimin e situatës. Formula e ndarjes së pushtetit deri të përfundoi procesi i bisedimeve me Serbinë e që do ta kishte formën përfundimtare dhe të pakthyeshme si dy shtete të pavarura do të ishte: LV-ja do të udhëhiqte me qeverinë dhe do ta kishte postin e KM kurse PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-Nisma do të merreshin vesh për udhëheqjen e Kuvendit të Kosovës sikur edhe për postin e presidentit. Jam i sigurt se Kurti nuk e pranon këtë propozim. **Po çfarë atëherë mendon të bëjë zotëri Kurthi:** Plani i Albin Kurthit është ta bëjë qeverinë e pakicës duke menduar se do t'i fitojë në mënyrë absolute

zgjedhjet lokale në tetor të këtij viti. Qeveria e formuar nga ai do të përdorej apo më mirë të them keqpërdorej për të fituar zgjedhjet lokale. Deri pas përfundimit të zgjedhjeve lokale nuk do ta dërgonte draftstatutin e Zajebnicës në Gjykatën Kushtetuese kurse pas zgjedhjeve do të fillojë të zbatojë të gjitha detyrimet që i ka marrë ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Me këtë do ta fitojë 100 për qind përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare e cila pastaj tërë presionin do ta bëjë te opozita që të përkrahë vendimet e Kurthit. Pas kësaj vjen radha e zgjedhjes së presidentit / presidentes. Albin Baba Kurthi do ta gjejë një kandidat që i përshtatet dhe i ndihmon, si bashkëkryerës për kapjen dhe kontrollin e të gjitha institucioneve si AKI, FSK, Gjykata Kushtetuese, KPK dhe KGJK dhe institucioneve tjera ku përgjegjësia ndahet 50 për qind me 50 për qind midis KM dhe Presidentit / presidentes. Kurti synon të kapë pushtetin dhe institucionet cep më cep, krejt dhe drejt. Nuk synon të qeverisë por të sundojë. Në vend të demokracisë parlamentare do të ofrojë autokraci personale. Sistemin shumëpartiak do ta ketë dekor të demokracisë duke e zbatuar sistemin njëpartiak si fytyrë reale të tiranisë. Natyrisht, nëse e durojnë apo e durojmë. Jam i sigurt se as nuk do ta durojnë e as nuk do ta durojmë. Sërish vjen marsi, sërish..... Qofsha i gabuar unë, Baba Vang (a)jeli dhe Kosova të ecën në rrugë të mbarë dhe të drejtë, krejtësisht njëkahore... drejt bashkimit me Shqipërinë.

Realizohet kursi “Udhëheqës i Poligonit dhe Mbikëqyrës i Vijave të Zjarrit”, gjenerata 01/2025

PRISHTINË, 4 PRILL - Në Qendrën e Stërvitjes Profesionale të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes është realizuar kursi “Udhëheqës i Poligonit dhe Mbikëqyrës i Vijave të Zjarrit”, gjenerata 01/2025. Ky kurs ka për qëllim trajnimet e specializuara për udhëheqësit dhe

mbikëqyrësit në operacionet e poligoneve dhe menaxhimin e vijave të zjarrit, duke siguruar nivel të lartë të gatishmërisë dhe sigurisë në terren. Ky trajnim është hap i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve profesionale, duke kontribuar në sigurimin e një ambienti të

sigurt dhe efikas gjatë ushtrimeve dhe trajnimeve në poligonet e stërvitjes. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes do t'i vazhdojë përpjekjet për ofrimin e trajnimeve të nivelit profesional, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe gatishmërisë për përballimin e detyrave ushtarake.



Protestë kundër vrasjeve: Po cenohet siguria

PRISHTINË, 4 PRILL - Shoqata “Roja e kohës” ka organizuar të premten protestë në Prishtinë kundër vrasjeve që kanë tronditur opinionin publik. “Jetën nuk e mbrojnë

armët, por drejtësia”, “Shteti që s’mbron jetën, ka dështuar”, “Çarmatosni rrugën, armatosni shkollat me dije”, ishin pankartat që mbanin protestuesit. Përfaqësuesi i Këshillit Organizues të protestës,

Isak Sfarça, bëri thirrje që të parandalohen vrasjet. “E kemi bërë këtë organizim për të alarmuar. Kosovën e ka kapluar një plagë e rëndë: vrasjet. Këtë fenomen ta ndalim sa më parë”, tha

Sfarça. Kryetari i Shoqatës “Roja e kohës”, Shaip Murseli, tha se dhuna po bëhet përditshmëri. Ai e cilësoi vrasjen e një pjesëtari të Policisë së Kosovës, alarm për shtetin.



NË KOTOR DISKUTOHET PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR POLICOR

KOTOR, 4 PRILL - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, i shoqëruar nga drejtori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Arben Paçarizi dhe bashkëpunëtorë të tjerë, mori pjesë në takimin e nivelit të lartë të shefave të policisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, i mbajtur në Kotor, Mal të Zi. Takimi u organizua dhe u mbështet nga projekti EU4FAST i Bashkimit Evropian, i cili synon parandalimin dhe luftimin e trafikimit të njerëzve dhe kontrabandës me migrantë. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar policor ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe



agjencive të sigurisë si Europol, Frontex, Interpol etj. Gjatë këtij aktiviteti u bë edhe

përrurimi i Qendrës së Bashkëpunimit Ndërkombëtar 24/7 në Policinë e Malit të Zi, e

cila është mundësuar dhe është mbështetur nga projekti EU4FAST.

Po ashtu, shefat e policive pjesëmarrëse dhanë zotime për fuqizimin e pikave të vetme të kontaktit 24/7 për bashkëpunim ndërkombëtar policor, si dhe për rritjen e ndërlidhshmërisë dhe ndërveprueshmërisë së bazave të të dhënave përmes kanaleve të sigurisë dhe komunikimit ndërkombëtar. Policia e Kosovës vazhdon të japë një kontribut të rëndësishëm në luftimin e krimit ndërkombëtar, duke vepruar si një partner i besueshëm dhe aktiv në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë. Angazhimi i saj në iniciativat ndërkombëtare është dëshmi e përkushtimit për ruajtjen e sigurisë, rendit dhe ligshmërisë në rajon dhe më tej.

ATK-ja SHËNON RITJE TË TË HYRAVE PËR PERIUDHËN JANAR - MARS

PRISHTINË, 4 PRILL - Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 Administrata Tatimore e Kosovës ka realizuar të hyra tatimore në vlerë prej 254.6 milionë eurosh, duke shënuar rritje prej 18.3 milionë eurosh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Kjo rritje është rezultat i përmirësimit të shërbimeve për tatimpaguesit, reformave të ndërmarra dhe rritjes së

transparencës në administrimin e tatimeve. Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe lehtësimi i procedurave ka ndikuar drejtpërdrejt në përmbushjen e obligimeve tatimore nga tatimpaguesit. Forcimi i llogaridhënies është mekanizëm i fuqishëm i institucionit tatimor, i cili ka rezultuar që të kemi zbatim të saktë të procedurave tatimore

si dhe rritje të integritetit. Krejt në fund, një ndër aspektet shumë të rëndësishme ka qenë dhe mbetet forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe qytetarët, për të cilën ATK-ja angazhohet vazhdimisht në dialog të hapur me komunitetin e biznesit për t'i adresuar sfidat dhe përmirësuar përmbushjen tatimore.



KOSOVA, SHEMBULL I HARMONISË FETARE DHE BASHKËJETESËS



PRISHTINË, 4 PRILL - Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim një delegacion nga Zyra Ndërkombëtare për Lirinë e Besimit (IRF) në Departamentin e Shtetit të ShBA-së, në krye me Michael Dozler, Sonia Fernandes dhe Brooke Young nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë. Kryeimami Sahiti i shprehu

mirëseardhje delegacionit nga ShBA-ja dhe më pas e njoftoi me organizimin e jetës fetare dhe të institucioneve të Bashkësisë Islame në vend. Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë e lirisë së besimit në Kosovë dhe angazhimit të Bashkësisë Islame për avancimin e të drejtave dhe lirive fetare në Kosovë. Kryeimami Sahiti theksoi se

Kosova është një shembull i harmonisë fetare dhe bashkëjetesës, ku besimtarët e feve dhe etnive të ndryshme bashkëjetojnë në paqe. Ai theksoi se Bashkësia Islame e Kosovës është e përkushtuar për promovimin e lirive fetare dhe të drejtës së besimit dhe respektimin e diversitetit, duke kontribuar kështu në forcimin e paqes dhe stabilitetit në vend.

289 kadetë policorë firmosin kontratat e punës

Prishtinë, 4 prill - Në ambientet e Policisë së Kosovës, të premten, pas përfundimit të të gjitha

fazave të testimeve, është bërë nënshkrimi i kontratave për marrëdhënie pune për kadetë policorë,

respektivisht për gjeneratën e 62-të të PK-së. Kjo gjeneratë pritet që trajnimin themelor ta fillojë më 7 prill

në përbërje prej gjithsej 289 kadetëve policorë, duke përfshirë diversitetin shumetnik.



“Jemi në siklet”: Pasojat për bizneset e Kosovës pas vendosjes së tarifës nga ShBA-ja

PRISHTINË, 4 PRILL - Mbi 60 për qind të produkteve nga kompania e Kosovës “Walone Fashion Group” shiten në tregun e Shteteve të Bashkuara, deri më tani pa ndonjë tarifë doganore. Por, kjo do të ndryshojë pas 5 prillit, kur hyn në fuqi vendimi i presidentit amerikan Donald Trump për tarifën prej 10-përqindësh për importet nga Kosova. Masa tregtare për Kosovën është pjesë e një vendimi më të gjerë të Uashingtonit, që shënjestron me tarifa të gjitha vendet e botës. Pronari i kompanisë, Valon Osmani, thotë se ky vendim do të ketë ndikim në biznesin e tij, pasi shumica e konsumatorëve janë amerikanë. Kompania “Walone Fashion Group” njihet për fustanet elegante dhe moderne të nusërisë. Osmani thotë “Radion Evropa e Lirë” se që shtatë vjet eksporton produkte në ShBA që kapin vlerën deri në 800 000 euro në vit. “Tani jemi në siklet, pasi nuk e dimë si do të reagojnë klientët, a do të vazhdojnë të porosisin apo do të anulohen disa porosi. Tani mbetet të shohim si do të ndikojë kjo situatë. Normalisht, do të marrim disa masa në varësi të zhvillimeve”, thotë ai. Osmani shprehet se nuk është i interesuar ta ulë sasinë e eksportit, por synon t’i rrisë çmimet e produkteve. Organizatat ekonomike në vend kanë paralajmëruar se tarifa prej 10 për qind do të rrisë çmimet e produkteve me origjinë nga Kosova, duke sjellë pasoja për bizneset. Ato thonë se që nga viti 2019, eksportet e përgjithshme të Kosovës në ShBA kanë shënuar rritje të ndjeshme dhe kryesisht

për shkak të përmirësimit të cilësisë së produkteve. Të dhënat e Doganës së Kosovës e konfirmojnë këtë trend. Në vitin 2019, eksportet drejt ShBA-së kapën vlerën e 3 milionë eurove, ndërsa tre vjet më vonë kjo shifër arriti në mbi 131 milionë euro. Ndërkaq, në tre muajt e parë të këtij viti, sipas Doganës, eksportet kanë arritur në 5.6 milionë euro, prej të cilave, 3.2 milionë euro i përkasin kategorisë së veshmbathjeve.

Pasojat për eksportuesit e Kosovës

Sipas kryetarit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, tarifa prej 10 për qind e vendosur nga ShBA-ja mund të ketë ndikim si në të ardhurat e bizneseve, ashtu edhe në uljen e numrit të punëtorëve. “Patjetër që do të ketë ndikim, sidomos në periudhë afatshkurtër. Duhet pasur parasysh se disa mallra të eksportuara nga Kosova në ShBA kanë pasur çmime më të ulëta, gjë që u ka dhënë një përparësi konkurruese prodhuesve kosovarë”, thotë Zeka për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, shtrenjtimi i produkteve që Kosova eksporton - për shkak të taksës së ShBA-së - mund të bëjë që të bjerë edhe kërkesa për to, rrjedhimisht edhe prodhimi. “Bizneset do të përpiqen të gjejnë tregje të reja, por kjo kërkon kohë, angazhim dhe investime. Nuk është diçka që ndodh brenda natës, nuk është



e lehtë të riorientohesh menjëherë në një treg të ri”, u shpreh Rafuna në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”. Për të zbutur efektin e tarifës mbi prodhuesit eksportues, organizatat ekonomike kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrë masa lehtësuese. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë i bëri thirrje Qeverisë që të mbështesë bizneset e prekura nga ky vendim.

Kërkohet heqja e tarifës ndaj mallrave amerikane

Ndërkaq, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i kërkoj Qeverisë pezullimin e tarifës doganore prej 10 për qind për mallrat nga Shtetet e Bashkuara. Pas kërkesës së presidentes, ministri në detyrë i Financave i

Kosovës, Hekuran Murati, të enjten vonë tha se kabineti qeveritar po e shqyrton tarifën ndaj importeve nga ShBA-ja. Kërkesë të njëjtë sikurse Osmani bëri edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, e cila vlerësoi se tani është momenti i duhur që Kosova të heqë plotësisht tarifën që aplikon për mallrat amerikane. “Kjo masë do të ndihmonte Kosovën që të pozicionohej më mirë në përpjekjet e ardhshme për të ndjekur një marrëveshje formale të tregtisë së lirë me Shtetet e Bashkuara”, thotë drejtuesi i kësaj ode, Arian Zeka. Nga ana tjetër, drejtuesi i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, mendon se institucionet duhet të shfrytëzojnë të gjitha kanalet diplomatike dhe ekonomike për të negociuar pezullimin, goftë edhe të përkohshëm, të

kësaj tarife. “Kemi pasur raste të ngjashme më parë. Për shembull, gjatë administratës së presidentit Trump, një tarifë doganore ndaj Kanadasë u pezullua për dy muaj. Pra, kjo është e mundur”, thekson ai. Përveç ndaj importeve të Kosovës, tarifë prej 10 për qind ShBA-ja ka vendosur edhe ndaj atyre nga Shqipëria. Serbisë i është vendosur tarifë prej 37 për qind, Bosnje e Hercegovinës 35 për qind dhe Maqedonisë së Veriut 33 për qind. Kurse, ndaj importeve nga Bashkimi Evropian në ShBA është vendosur tarifë prej 20 për qind. Kosova, e cila është e varur nga importet e BE-së, sipas përfaqësuesve të bizneseve, mund të ndiejë ndikim të dyfishtë nga këto tarifa, duke krijuar sfida të reja për ekonominë e vendit.

Qeveria thotë se po shqyrton tarifën ndaj importeve nga ShBA-ja



PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri në detyrë i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, tha se kabineti qeveritar ka qenë duke e shqyrtuar prej kohësh çështjen e tarifës ndaj mallrave me origjinë nga Shtetet e Bashkuara, pas kërkesës së presidentes Vjosa Osmani për ta pezulluar atë. Osmani i kërkoj qeverisë ta pezullojë tarifën doganore prej 10-përqindësh për mallrat nga ShBA-ja, një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump vendosi tarifë të ngjashme ndaj importeve nga Kosova. Por, Murati e kritikoi qasjen e presidentes Osmani, duke thënë se ajo e kishte postuar kërkesën në rrjetet sociale pak minuta pasi i kishte dërguar email qeverisë pas orarit të rregullt të punës pas orës 16:00. “Secili shtet serioz, këto çështje i trajton larg mediave, dhe publiku njoftohet kur të merret vendimi. Për më tepër, politikat

fiskale bien në fushëveprimin e ekzekutivit, konkretisht ministrisë përgjegjëse për financa”, tha Murati në një reagim në “Facebook”. Këshilltari për medie i presidentes Osmani, Bekim Kupina, e cilësoi përgjigjen e Muratit si “të turpshme dhe skandaloze”, duke thënë se letra e presidentes drejtuar qeverisë nuk ishte “thjesht veprim ekonomik, por veprim strategjik në raport me aleatin tonë strategjik e ekzistencial”. Murati tha se qeveria e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, kishte diskutuar gjatë mandatit të saj katërvjeçar me përfaqësues të Departamentit Amerikan të Tregtisë për arritjen e një marrëveshjeje për tregti të lirë mes ShBA-së dhe Kosovës. “Gatishmëria jonë si qeveri dhe si shtet për të pasur tregti të lirë e pa asnjë barrierë tarifore apo jo-tarifore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhdon të

qëndrojë edhe më tej”, tha ai. Të mërkurën në mbrëmje Trumpi vendosi tarifë bazë prej 10-përqindësh për importet nga të gjitha vendet e botës, përfshirë Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vendimi i Trumpit nxiti reagime gjithandej dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) dhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, i bënë thirrje Kosovës më herët ta tërheqë tarifën prej 10-përqindësh ndaj importeve nga ShBA-ja. Por, Murati nguli këmbë se ndikimi i tarifës së ShBA-së ndaj mallrave të Kosovës “ka ndikim të vogël”. “Fatmirësisht, Kosova bën pjesë në grupin e shteteve që u është vendosur shkalla tarifore minimale prej 10 %. Marrë parasysh edhe vëllimin e vogël tregtar që kemi, impakti financiar i pasjes apo jo të një regjimi tarifar ka ndikim të vogël në ekonominë tonë”, tha ai.

SERIALI 'ADOLESCENCE' SI INSTRUMENT I 'PEDAGOGJISË SË ZEZË'



Nga: Rafaela MARTETA

Së pari, çfarë është “pedagogjia e zezë”? Term për të përmbledhur një “metodë edukative”. Pohimi që “pedagogjia e zezë” është metodë edukative është paradoksal, sepse nuk bëhet fjalë për një ndërhyrje pozitive: të rriturit ushtrojnë pushtetin e tyre prej prindi për të nxitur te fëmijët plotësimin e nevojave dhe të mangësive personale. Termi përcjell edhe një histori praktikash, që nuk janë kaq të thjeshta për t’u përmbledhur në një rast si ky, por thelbi i kësaj pedagogjie është idealizimi i nevojave dhe i kërkesave të prindit ose të mësuesit. Fëmija bëhet një bartës i pavetëdijshëm i kushtëzimeve që shtypin pjesën më të gjallë dhe krijuese të tij qysh në moshë të njomë. Prindi e bën me qëllim të mirë, por niset përherë prej mendimit se e drejta është në anën e të rriturit duke i dhënë kësaj metode edukative nota të qarta manipuluese.

Në ç’mënyrë “Adolescence” është instrument i pedagogjisë së zezë?

Çfarë përfaqëson “pedagogjia e zezë” u sqarua më sipër. Është një instrument për të zotëruar dhe për të mbizotëruar mbi vullnetin e lirë të tjetrit dhe mbi pjesën e tij vitale dhe origjinale. Kështu vepron ky serial: u

mëson të rriturve të kenë frikë, të rrojnë me frikë. Recensionet e gjykojnë “Adolescence”-n si serialin e vitit 2025 (dhe jemi vetëm në mars të këtij viti) nisur nga shikimet dhe debatet që ka nxitur. Ky është një nga pushtetet e pedagogjisë së zezë: ka ndikim të menjëhershëm dhe afatgjatë, më shumë sesa shumë veprime ndërtuese edukative të përditshme. Çka më shtyn të ndaj këtë artikull është fokusi që recensionet, sidomos ato në gjuhën shqipe, kanë për serialin dhe jo për realitetin. Një shfaqje, e cilësdo gjini paraqet copëza realiteti, por për arsye që dihen e këtu nuk është rasti të listojmë, është një përqendrim dinamikash të ndërtuara në mënyrë simbolike, me synim për të marrë vëmendjen e publikut, të cilin shfaqja e ka identifikuar paraprakisht.

Asnjë konstrukt artistik nuk është i paqëllimshëm. Qëllimi i “Adolescence”-s është të shfaqë aspektin ekstrem dhe kulmor të rrezikut që praktikatat edukative bartin në vetvete. Përgjatë edukimit, natyra e rrezikut është e paparashikueshme, por e dimë që format e rrezikut janë mbas dere. Është ky rrezik që na mban përherë në ankth dhe të gatshëm për të menduar të keqen para së mirës. “Adolescence” ka sukses në publik sepse punon me ankthin që çdo prind ka natyrshëm. Ankthi na mbron, përdërisa nuk na merr peng

dhe nuk na kontrollon. Ndryshe nga sa thonë recensionet e shumta që shoh në rrjet, sidomos në gjuhën shqipe:

– “Adolescence” nuk flet për të gjithë ne, pavarësisht se protagonistët potencialë të historisë së serialit në një moment të caktuar mund të ishim secili prej nesh, por jo të gjithë ne. Një film nuk ka fuqi përgjithësuese, historia e filmit nuk është historia e secilit prej nesh dhe as e shumicës prej nesh. Kjo është vlera e tij simbolike, e cila do lexuar me kompetencë dhe do kontekstualizuar, madje edhe interpretuar në çelës pedagogjik, artistik etj. Por, një film nuk duhet lexuar si një e dhënë shkencore që ka aftësi për t’u përsëritur dhe për t’u përgjithësuar.

– Gjesti i dhunshëm dhe ekstrem i protagonistit nuk është risia e filmit. Para këtij filmi kemi parë të tjerë me subjekt të tillë, madje në kontekstin tonë sapo kaluam një traumë shoqërore për vdekjen e Martininit dhe nuk është as e para e llojit.

– “Adolescence” i mëshon normalitetit të një familjeje me të dhëna të mesme dhe prapë na bën të mendojmë se ajo familje mund të jemi ne. E papritura e dhunshme e protagonistit nuk lexohet si një dramë e personit, personale,

por si një e keqe që përfshin një familje në dukje normale. Po cila është familja normale mesatare në imazhin tonë kolektiv?

Ajo e filmit?

Çdo familje është e përvëçme, çdo qenie është e përvëçme dhe e pangjashme. Po të ishte kaq i thjeshtë edukimi “Adolescence”, nuk do të çante tregun me një dhunë të ngjashme me frikërat tona më të mëdha. Nuk duhet harruar se me frikërat tona të mëdha behët para e madhe.


– “Adolescence” është në gojën e të gjithëve. Vetë unë jam rekomanduar nga më shumë se një person ta shoh si një film shumë instruktiv. Por, me aspak mendjemadhësi them se “Adolescence” nuk më mëson gjëra të dëshirueshme dhe ndërtuese. Më mëson në të kundërt mënyrën sesi punon ankthi dhe frika, si një forcë paralizuese që nuk e zhvendos debatin pedagogjik dhe edukativ ku duhet dhe si duhet. Po pse duhet “Adolescence” për të kuptuar se të rinjtë, si dje ashtu edhe sot kanë një parehati që e karakterizon moshën, po edhe një ligjërim të tyrin që karakterizon moshën dhe gjendjet e tyre? Pse u dashka që prindërit të njohin kuptimet që të rinjtë u japin emotikoneve apo termave të veçantë të komunikimit virtual, që megjithatë, nuk kanë lindur

prej filmit dhe me filmin?

– Pse filma të tjerë me natyrë pedagogjike ndërtuese nuk e “trembin” ndërgjegjen tonë si ky serial?

Është e thjeshtë! E zgjojnë! E zgjojnë!

“Adolescence” e mpin ndërgjegjen dhe veprimin tonë, duke pritur momentin kur po na vjen radha! Për shembull, “Detachment” është një film po kaq i fortë: kriza e mësuesit, kriza e shkollës, kriza e moshës adoleshenciale, kriza personale e disa prej protagonistëve, njëri vret veten në fund të filmit. Është i fortë, por është i një tjetër natyre. Flet për rreziqet e edukimit, por dëshmon edhe perspektiva dhe veprime konkrete për të dalë nga tuneli. “Adolescence”, më shumë se për adoleshencën flet për krizën e të rriturve dhe paralizën që ka kapluar rolin e tyre dhe pamundësinë për ta tejkaluar. Nëse e përjetojmë si verdikt final “fatin” e “Adolescence”, kemi arsye të kemi frikë. Nëse e përjetojmë si një forcë lëvizëse, duhet të ndërmarrim veprime, që do të thotë: më pak seriale, më pak divan, më pak TV, më pak ideologji, më shumë aktivizëm në realitet, me fëmijët, me familjen. Pa frikë! Me guxim! Jashtë ndodh jeta e vërtetë; të mos jemi thjesht konsumues të këtij skenari, të bëhemi prodhues të përmbajtjeve tona, proaktive ...



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drita edhe me afër titullit, Malisheva mposht Prishtinën

MALISHEVË, 4 PRILL - Drita e Gjilanit ka bërë edhe një hap tjetër të madh drejt titullit të kampiones, pasi e ka mposhtur të premten Feronikelin '74 me rezultat 0-

1. Kjo ndeshje i ka takuar javës së 27 në Superligë, kurse golin e vetëm në ndeshje e shënoi Arb Manaj në minutën e fundit të pjesës së parë. Me tri pikët e reja,

Drita është në vend të parë me 60 pikë, "Nikli" është në vendin e fundit me 14 pikë. Në ndeshjen tjetër Malisheva e mposhti Prishtinën (1-0). Goli i shënuar nga Donart

Vitija në minutën e dytë, doli përcaktues për fatin e ndeshjes. Malisheva është në vendin e tretë me 44 pikë, kurse Prishtina e katërta me 36 pikë.



Ministri Çeku dhe KOK-u kërkojnë sqarim nga UEFA për heqjen e flamurit të Kosovës në Beograd

"Epoka e re"

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka reaguar pas heqjes së flamurit të Kosovës në Kongresin e UEFA-së në Beograd. Çeku ka thënë se largimi i simboleve është sulm i drejtpërdrejtë ndaj integritetit shtetëror të Kosovës, derisa pret reagim të mirëfilltë ndërkombëtar. "Largimi i flamurit të Republikës së Kosovës në Kongresin e UEFA-së në Beograd është veprim i turpshëm, i papranueshëm dhe i dënueshëm. Kosova është shtet i pavarur, që përfaqësohet në botë përmes simboleve shtetërore. Federata e Futbollit e Kosovës është anëtare me të drejta të plota e UEFA-së. Largimi i simboleve është sulm i drejtpërdrejtë ndaj integritetit shtetëror të Kosovës dhe si i tillë nuk mund të kalojë pa reagim të mirëfilltë

ndërkombëtar. Presim sqarime nga UEFA-ja dhe veprime efektive për të adresuar përgjegjësinë për këtë shkelje të rregullave të tyre të brendshme dhe këtë sulm ndaj shtetit të Kosovës", ka thënë Çeku, i cili ka dënuar edhe gjuhën e ashpër të përdorur nga Federata e Serbisë e cila pranon të instrumentalizohet nga politika shoviniste serbe. "Dënojmë ashpër gjuhën e përdorur nga Federata e Serbisë në komunikatën e tyre, e cila mjerisht, me vetëdije të plotë pranon të instrumentalizohet nga politika shoviniste serbe. Shteti serb nuk ka ndryshuar, është i njëjti që ka kryer masakra e gjenocid para pak dekadash. As atëherë e as sot, nuk e ka kursyer as sportin. Për këtë arsye, kërkojmë nga federatat evropiane e botërore të sportit të mos organizojnë ngjarje sportive në Serbi për sa kohë ajo nuk e ndryshon qasjen në



raport me pjesëmarrjen e Kosovës", ka shtuar Çeku. Edhe Komiteti Olimpik i Kosovës ka shprehur shqetësimin për heqjen e flamurit të Republikës së Kosovës nga ambientet e Kongresit të UEFA-s, i cili u mbajt në Beograd të Serbisë. KOK-u konsideron se ky akt përbën një sulm të drejtpërdrejtë jo vetëm ndaj simboleve shtetërore të Kosovës, por edhe ndaj vlerave themelore të sportit: respektit, barazisë dhe përfshirjes.

"Komiteti Olimpik i Kosovës shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë për veprimin e papranueshëm të heqjes së flamurit të Republikës së Kosovës nga ambientet e Kongresit të UEFA-s, i cili u mbajt në Beograd të Serbisë. Edhe më shqetësues dhe i turpshëm është fakti që flamuri i vendosur në mesin e flamujve të shteteve tjera përfundoi në duart e huliganëve, të cilët më pas e dogjën përpara ambienteve ku po mbahej Kongresi. Ky akt përbën një

sulm të drejtpërdrejtë jo vetëm ndaj simboleve shtetërore të Kosovës, por edhe ndaj vlerave themelore të sportit: respektit, barazisë dhe përfshirjes", thuhet në reagimin e KOK-ut. Komiteti Olimpik i Kosovës ka kërkuar sqarim nga UEFA lidhur me heqjen e flamurit të Kosovës. "KOK kërkon sqarime nga organizatori i Kongresit, në këtë rast UEFA, për heqjen dhe djegien e flamurit, e njëkohësisht kërkojmë marrjen e masave të mikpritësit të këtij Kongresi, i cili sipas pamjeve të publikuara edhe gjatë punimeve të Kongresit u përfshi në aktet e heqjes së flamurit. Kosova dhe institucionet tona sportive janë anëtare të barabarta në të gjitha organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe, si të tilla, duhet të trajtohen me dinjitet dhe respekt në çdo ngjarje sportive, pavarësisht se kush është vendi mikpritës", thuhet në reagimin e KOK-ut.

'Beteja e fundit' për vendin e parë

PRIZREN, 4 PRILL - Fundjava do të dhurojë ndeshje shumë interesante në javën e 28- të Pro Credit Superligës, apo të fundit për garat e rregullta. Kjo xhiro është vendimtare se kush do të jetë në vendin e parë në mes të Bashkimit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë një pikë më shumë, por edhe për pozitë sa më të lartë para "play-off"-it ndërmjet Pejës (41 pikë), Golden Eagle Yllit (41) dhe Vëllaznimit (40). Bashkimi dhe Trepça kanë siguruar gjysmëfinalet e "play-off"-it, ndërsa në çerekfinale janë



kualifikuar Sigal Prishtina, Peja, Golden Eagle Ylli dhe Vëllaznimi. Bora do të luajë në "play-out", ndërsa Proton Cable Prizreni është i fundit për këtë

edicion. Takimi i parë është në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit. Prizrenasit janë në vendin e fundit me pesë fitore e 22 humbje, ndërsa therandasit kanë 14 fitore e 13 humbje, aq sa edhe Peja. Trepça do të përballet me Borën. Kampionët kërkojnë fitoren dhe pozitën e parë, ndërsa prishtinasit janë në vendin e shtatë dhe do të luajnë në "play-out" me finalistin e Ligës së Parë të Meshkujve për një vend në elitë edicionin e ardhshëm. "Xehetarët" kanë 18

fitore e nëntë humbje, ndërsa prishtinasit nëntë fitore e 18 humbje në edicionin debutues në Superligë. Takim shumë interesant shihet ai i Bashkimit dhe Pejës, ku të dyja skuadrat do ta japin maksimumin për fitore. Prizrenasit janë në vendin e parë me 19 fitore e tetë humbje, ndërsa "verdhezinjtë" kanë 14 fitore e 13 humbje. Java 28 mbyllet me ndeshjen në mes të Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës në Gjakovë, apo finalistëve të Ligës Unike, që kishte përfunduar me triumfin e

skuadrës kuqezi. Vëllaznimi ka 13 fitore e 14 humbje, kurse "bardhekaltrit" janë në pozitën e tretë me 16 fitore e 11 humbje.

SUPERLIGA - 28

Të shtunën takohen:
17:00 Prizreni - Ylli
19:00 Trepça - Bora

Të dielën takohen:
Bashkimi - Peja
Vëllaznimi - Prishtina

Adem Mekiqi, MVP i javës në Superligë

PRIZREN, 4 PRILL - Java e 27, e parafundit për garat e rregullta, kishte shumë ndeshje interesante. Basketbollisti me indeksin më të lartë në këtë xhiro ishte Adem Mekiqi i Borës 37. Ai ndaj Proton Cable Prizrenit e mbylli ndeshjen me 29 pikë, tetë kërcime dhe

tetë asistime, duke u shpallur edhe MVP i kësaj xhiroje. Fitore të rëndësishme regjistroi edhe Golden Eagle Ylli ndaj Vëllaznimit, e aty u dallua Jalen Nesbitt me 19 pikë, 11 kërcime dhe shtatë asistime, duke pasur indeksin 32, apo të dytin më të lartën e kësaj

xhiroje. Bashkimi fitoi në kryeqytet ndaj Sigal Prishtinës, duke siguruar gjysmëfinalet e "play-off"-it, kurse u dallua dyshja Mack Smith me 19 pikë, gjashtë kërcime dhe tri 3 asistime dhe Erik Copes me 17 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime. Wendell Green

shënoi 27 pikë, por kishte edhe gjashtë topa të humbur, duke ndikuar të ketë indeksin 19. Trepça me fitore ndaj Pejës siguroi gjysmëfinalet, ndërsa nga verdhezinjtë më i dalluari ishte Tekele Cotton me 24 pikë, pesë kërcime dhe një asistim.



De Bruyne konfirmon largimin nga Manchester City

MANCHESTER, 4 PRILL - Kevin De Bruyne ka njoftuar për largimin nga Manchester City. Pas dhjetë vjetësh pjesë e qytetarëve, rrugët në mes të lojtarit dhe skuadrës angleze do të ndahen në fund të sezonit aktual. Belgut i skadon kontrata dhe ka vendosur të mos e rinovojë, duke u larguar si futbollist i lirë. Lajmin për largimin nga City e ka dhënë

vetë lojtari nëpërmjet një letre të gjatë në rrjetet sociale. “I dashur Manchester! Duke parë këtë, e dini çfarë do të vijë. Kështu do të tregohem i drejtpërdrejtë duke të thënë se do të jenë muajt e fundit si lojtar i Manchester Cityt. Nuk është e lehtë të shkruash, por si futbollistë e dimë se kjo ditë do të vijë. Kjo ditë ka ardhur dhe është mirë ta zbuloni më

parë. Futboli më dërgoi te të gjithë ju dhe te ky qytet. Duke ndjekur ëndrrën time duke mos e ditur se do të ma ndryshojë jetën. Ky qytet, ky klub, këta njerëz më dhanë çdo gjë. Nuk kisha zgjedhje tjetër. Dhe ne fituam çdo gjë. Na pëlqen apo jo, është koha për të thënë mirupafshim. Fëmijët e mi dhe unë jemi mirënjohës çfarë do të thotë

ky vend për ne. Pasaporta e fëmijëve tonë do të jetë gjithmonë Manchesteri. Do të jetë gjithmonë shtëpia jonë. Fjalët nuk janë të mjaftueshme për 10 vitet që kaluan. Çdo histori e ka një fund, por ky është kapitulli më i mirë. Le t’i shijojmë çastet e fundit. Me shumë dashuri”, ka shkruar De Bruyne. 33-vjeçari ka gjashtë tituj të



Premierë Ligës të fituara, një Ligë të Kampionëve dhe një FA Cup me Manchester Cityn.

Gjoni Palokaj: Pres përkrahje nga shqiptarët dhe fitore në Dortmund

PRISHTINË, 4 PRILL - Gjoni Palokaj, që ka një seri të shkëlqyer si luftëtar profesionist në arte luftarake (MMA), të shtunën në Dortmund, me përkrahjen edhe të bashkatdhetarëve, pret fitoren e radhës. I lindur më 13 shkurt 1995 në Hanover, me prejardhje nga fshati Velezh i Prizrenit, ai garon në kategorinë me peshë pendël -66 kg dhe ka një rekord profesional prej 10 fitoresh e 3 humbesh. Gjoni filloi rrugëtimin e tij në MMA nën udhëheqjen e xhaxhait dhe trajnerit të tij David Palokaj, themelues i Fight school Hannover. Davidi ka një karrierë të pasur në MMA, Luta Livre BJJ dhe boks, me përvojë të gjerë stërvitore në Brazil, të cilën me mjaft sukses po e përcjell te Gjoni. Në vitin 2023 Gjoni nënshkroi kontratë me OKTAGON MMA, një nga organizatat më të mëdha të MMA-së në Evropë. Ai ka shënuar fitore të rëndësishme



në këtë organizatë, duke përfshirë një fitore me vendim unanimit kundër Karol Ryšavý më 9 nëntor 2024. Aktualisht ai është në një seri prej pesë fitoresh radhazi dhe synon të kalojë në Ultimate Fighting Championship (UFC). Meçi i tij i ardhshëm është më 5 prill 2025 kundër sllovakut Marco Novak në eventin OKTAGON 69, që do të mbahet në

Westfalenhalle në Dortmund të Gjermanisë. Për meçin ka interesim veçmas nga diaspora shqiptare. Kapaciteti i sallës është 20 mijë vende dhe të gjitha biletat janë shitur. “Të shtunën pres ta shënoj fitoren e radhës ndaj Novakut. Besoj që në Dortmund do të ketë edhe shumë shqiptarë që do të më japin edhe më shumë zemër drejt fitores”, ka thënë Palokaj në prag të meçit. Gjoni gjithmonë hyn në ring me flamurin shqiptar. “Kur e mbaj flamurin kuq e zi në shpinë, ma jep krejt fuqinë e botës. Faleminderit shqiptarë që më përkrahni! Faleminderit Zot që më ke lindur shqiptar!”, ka thënë ai. Përveç karrierës së tij në MMA, Gjoni ka përfunduar studimet në Inxhinieri Elektronike dhe ka punuar në fabrikën e “Volkswagen”-it në Hannover. Tani është fokusuar tërësisht në karrierën sportive.

Curry fiton duelin me Le Bronin, Antetokounmpo një ‘përbindësh’ për Bucksin

LOS ANXHELOS, 4 PRILL – Golden State fitoi me rezultat 123-116 në fushën e lakersave, në një përballje mes dy ekipesh që luftojnë për titullin në NBA. Stephen Curry me 38 pikë ishte lider në fushë për Warriorsin, mbështetur edhe nga

Podziemski me 28 pikë. Ndërsa 33 pikët e Jamesit dhe 31 të Reavesit nuk mjaftuan për lakersat. Jashtë fushës fitoi edhe Milwaukee, që mundi me shifrat 126-113 Philadelphia. Protagonist ishte Antetokounmpo, me një “tripledouble” (35 pikë, 17 rebounde, 20 asistime). Zhgënjëu skuadra e Torontos, që në fushën e vet u mund me rezultat 112-103 nga Portlandi, ndeshje ku dallimin e bëri Sharpe me 36 pikë. Ndalet pas gjashtë fitoresh skuadra e Miamit, që u mund me rezultat



110-108 në fushën e saj nga Memphis. Ja Morant me 30 pikë u dallua për miqtë, ndërsa 35 pikët e Tyler Herros për Miamin mbetën për statistikë. Fitoi edhe Minnesota, 105-90 ndaj Brooklynit, sfidë ku Anthony Edwards realizoi 28pikë.

SHKURT

Khaka, ‘mbret’ i pasimeve në Bundesligë

Granit Khaka vazhdon të tregojë përse është një nga mesfushorët më të rëndësishëm në futbollin evropian. Sipas statistikave të fundit nga “Bundesliga Match Facts”, mesfushori shqiptar nga Kosova, i cili luan për Bayer Leverkusenin, kryeson Bundesligën për performancën më të lartë në pasime. Me 1966 pasime të suksesshme, Khaka arrin një performancë pasimi prej 67.0, duke lënë pas rivalët kryesorë, Angelo Stiller të Stuttgartit dhe Joshua Kimmich të Bayern Munichut. Ky sukses vjen në një sezon të mirë për Leverkusenin, që po lufton për titullin në Bundesligë dhe ka shfaqur një stil loje dominues nën drejtimin e trajnerit Xabi Alonso. Roli i Khakës në këtë ekip është kyç, duke qenë dirigjenti i mesfushës dhe një faktor vendimtar në ndërtimin e aksioneve sulmuese të skuadrës.

Usyk: Kjo është ëndrra ime, vështirë të realizohet

Nuk ka asgjë në boks që Oleksandr Usyk nuk e ka fituar. Ai ishte kampion i padiskutueshëm në peshën “cruiser weight” para se të bënte të njëjtën gjë edhe në peshën e rëndë, duke i fituar të gjitha duelet në karrierën e tij. Kjo vlen edhe për karrierën e tij amatore, kur ka fituar medaljen e artë olimpike apo të artën në Kampionatin Botëror dhe atë Evropian. Por ukrainasi ka një ëndërr që ai beson se nuk do të jetë në gjendje ta realizojë kurrë. Usyk e di se nuk do të arrijë ndonjëherë të luftojë në vendin e tij si kampion bote. 38-vjeçari nuk beson se lufta në Ukrainë do të ketë mbaruar përpara se të tërhiqet nga sporti. “Tani mendoj se nuk është e mundur”, ka thënë ukrainasi për “Sky Sports”. “Rusia lufton me Ukrainën, ka shumë raketa. Unë flas me vajzën time 14 vjeçe. ‘Hej, si jeni?’ ‘O baba, kjo natë ishte e tmerrshme’. Kështu që, të dueloj si kampion bote para fansave të mi nuk besoj se do të realizohet ndonjëherë”, ka deklaruar Usyk.

Unitedi, gati 100 milionë euro për transferimin e Valverdes

Manchester United po planifikon të bëjë ndryshime të shumta në merkaton e verës. Ruben Amorim po mendon ta forcojë repartin e mesfushës për sezonin e ardhshëm. Dëshira e madhe e trajnerit portugez është uruguaiiani i Real Madridit, Federico Valverde. “Djajtë e Kuq” janë të gatshëm të ofrojnë deri në 100 milionë euro për 26-vjeçarin. Valverde është një lojtar që mund të mbulojë më së miri disa role qoftë në mesfushë dhe në mbrojtje. Unitedi është i gatshëm të paguajë një shifër të kënaqshme për Valverden, 100 milionë euro. Duket e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që Real Madridi të heqë dorë nga njëri prej lojtarëve më të rëndësishëm dhe që është shumë i vështirë për t’u zëvendësuar.

Mourinho sërish në listë për trajner të Brazilit

Në listën e ngushtë të katër kandidatëve për ta marrë drejtimin teknik të kombëtares braziliane është edhe Jose Mourinho. Sipas medieve argjentinase, i preferuari i presidentit të CBF-së, Ednaldo

Rodrigues, mbetet Carlo Ancelotti, i cili ka edhe një vit kontratë me Real Madridin dhe duket se synon ta respektojë marrëveshjen. Kështu favoriti për bankinën e “Selecaos” është portugezi

Jorge Jesus, i cili tani drejton sauditët e Al Hilalit me të cilët duhet të luajë edhe në Botërorin e Klubeve dhe për këtë arsye, nëse nuk jep dorëheqje më parë, nuk do të jetë në dispozicion deri në mes

të korrikut (Brazili duhet të luajë dy ndeshje kualifikuese për Kupën e Botës në qershor). Dy kandidatët e tjerë janë gjithashtu portugezë, njëri është Abel Ferreira, i cili ka fituar gjithçka në Amerikën e

Jugut në krye të Palmeiras dhe tjetri, një ‘nominim’ i kohëve të fundit, Jose Mourinho, i cili mund të largohet nga Fenerbahçe në fund të sezonit, edhe për shkak të polemikave që ka shkaktuar në Turqi.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, neni 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 602/25 të datës 04.04.2025 të Kryshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A, me datë 04.04.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK

- I. Titulli: Mbledhës i mbeturinave – Punëtor Fizik
Numri i ekzekutuesve: 2
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla Fillore
Përvoja e punës: Së paku një (1) vit
I raporton: Menaxherit të Njesisë të Mbledhjes dhe Transportimit të Mbeturinave
Koeficienti i pagës: 457.87 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
- Mbledh mbeturina dhe bënë zbrazjen e Kontejnerëve dhe mjeteve tjera për mbeturina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njesisë së Mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 07.04.2025 deri me datë 22.04.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 29.04.2025.
- Afati për ankesë nga data 30.04.2025 deri me datë 02.05.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 14.05.2025.
- Afati për ankesë nga data 15.05.2025 deri me datë 19.05.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 26.05.2025.
- Afati për ankesë nga data 27.05.2025 deri me datë 29.05.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 02.06.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gani Gexha B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 811145219 të lëshuar nga ATK.

- Dulë Gjuraraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. “Shaban Gola” Lipavec KK Gjakovë.

- Beqir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazrek Has Prizren.

- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Hevzi Latifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës profesionale “Ymer Prizreni” Prizren.

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Hajrush Gashi shpall të pa vlefshme dëftesën e klasës 1 deri 9 të shkollës fillore “Bajram Curri” në Kurushë të Madhe.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Demokrat Rizanaj shpall të pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gani Çavderbasha” në Prizren.

- Dila Sopjani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zef Lushmarku" Fshati Vilezh.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Arbër Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Naim J Gashi, B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 811147463 të lëshuar nga ARBK.

Gani Gashi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 811145219 të lëshuar nga ATK.



U osnovu člana 8, člana 10 stav 2.2 i člana 15 Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 01.12.2010, člana 7 Administrativne upute MFPT br. 01/2024 o uređenju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je dio Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 31.10.2017, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora J.P. "Përparimi" Sh. A, i na osnovu odluke br. Protokola 604/25., a na osnovu rješenja br. protokola 604/25 od 04.04.2025, godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L "Perparimi" Sh. A od 04.04.2025, saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. **Naslov:** Skupljač otpada – Fizički radnik
Broj izvršilaca: 2
Radno vrijeme: 40 časova nedeljno
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Osnovna škola
Radno iskustvo: Najmanje jedne godine
Izveštava: Menadžer Jedinice za prikupljanje i transport otpada
Iznos mjesečne plate: 457.87 Euro bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Obavlja sve poslove prikupljanja i utovara otpada.
- Skuplja otpad i prazni kontejnere i druge posude za otpad ili kese od korisnika usluga u privatnom i državnom sektoru.
- Nakon praznjenja kontejnera i drugih posuda, dužan je da ih vrati na određena mjesta i da vodi računa o njima.
- Odgovoran je za efikasno i kvalitetno obavljanje poslova, kao i za korektno ponašanje prema građanima-korisnicima usluga.
- Za svoj rad odgovara Menadžeru Jedinice za prikupljanje i transport otpada.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Formular za prijavu J.P. "Përparimi" Sh. A - Vuçitri;
- Dokaz o školskoj kvalifikaciji (skenirana kopija);
- Izvod iz matične knjige rođenih (online sertifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Vijeća sudova Kosova, koja potvrđuje da nema krivičnih osuda u centralnoj evidenciji Republike Kosovo (online sertifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirana kopija) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana kopija).

Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Da bude državljanin Republike Kosovo.
- Da ima punu poslovnu sposobnost.
- Da govori barem jedan od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test od sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 07.04.2025 do 22.04.2025 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 29.04.2025.
- Rok za žalbu je od 30.04.2025 do 02.05.2025.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 14.05.2025.
- Rok za žalbu je od 15.05.2025 do 19.05.2025.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 26.05.2025.
- Rok za žalbu je od 27.05.2025 do 29.05.2025.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 02.06.2025.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se pritužba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, žalba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavi formular u Arhivu N.P.L "Perparimi" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom potrebnom dokumentacijom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese: hrperparimi@gmail.com .

N.P.L "Përparimi" Sh. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog nadmetanja odvijat će se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

Objašnjenje:

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje termina koji se koriste u rodnom kontekstu, gde reči i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

Zaključak:

N.P.L "Perparimi" Sh. A u Vuçitru pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo, a posebno ohrabruje pripadnike manjinskih zajednica, osobe sa invaliditetom i manje zastupljeni pol da se prijave.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Tree Solar" LLC Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin Fotovoltaik – Parku Solar Hybrid "Tree Solar" PV 85 MWp dhe Battery 20 MW në Smallushë, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.05.2025 në ora 10:00 në objektin e Komunës se Lipjanit, Rruga "Shqipëria" Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania "Tree Solar" LLC Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Tree Solar" LLC Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin Fotovoltaik – Parku Solar Hybrid "Tree Solar" PV 85 MWp dhe Battery 20 MW në Smallushë, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 03/04/2025 me numër të protokollit 02/01/292 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës:	“Zyrtar i Lartë i Prokurimit”
Nr. i kërkuar:	Një (1) pozitë, në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës:	KE/KJ-09/2025
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli VIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të pa caktuar
Periodha Provuese:	3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Harton planet e punës në pajtim me Mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Drejtorisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Harton dhe zhvillon dokumentacionin e prokurimit, duke përfshirë edhe planin e blerjes, orarin e prokurimit, kërkesat për oferta, planin e vlerësimit, planin e negocimit dhe rekomandimin e blerjes;
- Analizon aktivitetet aktuale të prokurimit dhe rekomandon përmirësimin përmes metodave më efikase të prokurimit dhe standardizimit të procedurave të prokurimit;
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik;
- Përgatit kontrata dhe dosje te tenderit dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen në mënyrën e duhur;
- Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë;
- Asiston dhe këshillon komisionin e vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve
- Kujdeset që të gjitha informacionet e aktiviteteve të jenë të bartura në librin e evidencës
- Sigurohet që të gjitha dokumentet përbërëse të aktivitetit janë të nënshkruara dhe vulosura
- Sigurohet për kompletimin e lëndëve
- Siguron mbajtjen e të dhënave në detaje për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar;
- Kryen edhe detyra tjera të lidhura me pozitën, në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme sipas nevojës nga Mbikëqyrësi.
- Për punën e tij i raporton Drejtorit të Prokurimit.
- Në bashkëpunim të ngushtë me njësitin kërkuar monitoron përcaktimin e procedurave për inspektimin e vendit të punimeve, materialeve, sigurimin e dorëzimit efektiv, ruajtjen dhe sigurinë e artikujve të përfshirë në kontratë dhe variacionet/ndryshimet;
- Në bashkëpunim me aktetë relevant të Kompanisë mbledh të dhëna nga burime të shumta për prezantimin e opsioneve për shërbimet para shpalljes së njoftimit për kontratë (tender);
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit dhe njësitë kërkuar, shqyrton informacionet teknike dhe hartimin e raporteve të detajuara për prezantime dhe vlerësime që përfshijnë kontratat specifike;
- Për punën e tij i përgjigjet Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për çështje Administrative ndërsa për çështje profesionale/ operacionale Kryeshefit Ekzekutiv.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 vite pune

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

- 6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:
- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.
 - * në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM “ Pastrimi” SH.A.
- 6.2 Dorëzimi i aplikacionit bëhet:
- * vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com dhe
 - * edhe në formë fizike në rastet e pozitave teknike.

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 05/04/2025 deri me datën 22/04/2025.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në gjashtëdhjetë (60) pikë;
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:


Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u kompaniji KRM "Čistoća" a.d. konkretno članovi 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" SH. A, u Odluci od 03/04/2025 sa brojem protokola 02/01/292 izvršnog direktora RPO "PASTRIMI" SH. A, objavite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv posla:	"Viši službenik za nabavke"
Ne. Obavezno:	Jedna (KSNUMKS) pozicija, u KRM "PASTRIMI" SH.A
Referentni broj:	EC/KJ-09/2025
Koeficijenti / Mesečne plate:	Nivo VIII
Trajanje ugovora o radu:	Sa neodređenim vremenom
Probni rok:	3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- u skladu sa supervizorom izrađuje planove rada za sprovođenje zadataka definisanih na osnovu ciljeva Direktorata i daje preporuke u vezi sa ostvarivanjem ciljeva;
- Izrađuje i razvija dokumentaciju o nabavci, uključujući plan kupovine, raspored nabavke, zahtjeve za ponudu, plan procjene, plan pregovora i preporuku za kupovinu;
- analizira trenutne aktivnosti nabavke i preporučuje unapređenje kroz efikasnije metode nabavke i standardizaciju postupaka nabavki;
- Obezbeđuje da su svi zahtevi za nabavku u skladu sa zakonima i pravilima o javnim nabavkama;
- Priprema ugovore i tenderske dosije i obezbeđuje da su metode i tehnike nabavke razumljive i sprovedene na pravilan način;
- Priprema standardne obrasce i procedure, u zavisnosti od načina nabavke, i obezbeđuje blagovremeno raspisivanje ponuda i njihovo podnošenje;
- Pomaže i savetuje komisiju za evaluaciju tokom procesa evaluacije ponuda
- On osigurava da se sve informacije o aktivnostima prenose u knjigu zapisa
- Obezbeđeno je da su svi konstitutivni dokumenti aktivnosti potpisani i obeleženi
- Obezbeđuje završetak kurseva
- Obezbeđuje vođenje detaljne evidencije o svim ponuđačima koji učestvuju, o donesenim radnjama i odlukama, kao i potpisivanje komentara od strane svakog člana;
- Obavlja i druge poslove u vezi sa radnim mjestom, u skladu sa zakonima i propisima koje supervizor može razumno zahtijevati.
- On izveštava o svom radu direktoru nabavke.
- U bliskoj saradnji sa jedinicom koja je podnijela zahtev, prati određivanje procedura za pregled lokacije radova, materijala, obezbeđivanje efikasne isporuke, skladištenja i bezbednosti predmeta uključenih u ugovor i varijacija/promena;
- U saradnji sa relevantnim zainteresovanim stranama Društva, prikuplja podatke iz više izvora za prezentaciju opcija za usluge pre objavljivanja obaveštenja o ugovoru (tendera);
- U saradnji sa Direkcijom za nabavke i jedinicama koje su podnijele zahteve, razmatra tehničke informacije i izrađuje detaljne izveštaje za prezentacije i evaluacije koji uključuju konkretne ugovore;
- Za svoj rad, on je odgovoran odgovornom službeniku za nabavke za administrativna pitanja i za profesionalna / operativna pitanja izvršnom direktoru.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ biti državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ Potrebno obrazovanje: Osnovne studije iz ekonomije, Pravo, Javna uprava
- ✓ Potrebno radno iskustvo: Najmanje 2 godine rada

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE stariji od 3 meseca	✓

6. Kako se prijaviti na konkurs i prijaviti se:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
- * preuzimanjem sa zvaničnog sajta na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "PASTRIMI" sh.a..
 - * u Kancelarijama za ljudske resurse RPO "PASTRIMI" a.d.

- 6.2 Podnošenje prijave vrši:
- * samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com i
 - * čak iu fizičkom obliku u slučajevima tehničkih pozicija.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;

Javni konkurs traje 15 dana od 05/04/2025 do 22/04/2025.

Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Kandidati se ocenjuju na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- ✓ Pismeni test se ocenjuje do šezdeset (60) bodova;
- ✓ Intervju (usmeni test) se ocenjuje do trideset (30) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obavestavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavешteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

- Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;
- Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,
- Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
- Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
Since 1903